




USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



RAPORTI I MONITORIMIT TË ORGANIT SHQYRTUES TË PROKURIMIT

(Janar 2020 – Mars 2021)



AUTOR:

Agon Hysaj

Tetor 2021

Ky raport është përgatitur nga Demokraci Plus (D+) dhe mbështetur nga USAID përmes aktivitetit Komuna Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse (USAID TEAM). Qëndrimet e autorit të shprehura në këtë raport nuk pasqyrojnë medoemos pikëpamjet e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) ose qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.



RAPORTI I MONITORIMIT TË ORGANIT SHQYRTUES TË PROKURIMIT



Përmbajtja

Përmbajtja	4
Shkurtesat	5
Hyrje	6
Përmbledhje	7
OSHP gjatë vitit 2020 dhe 2021	8
Roli i OSHP-së në mosefikasitet në prokurim publik	8
Vonesat në vendimmarrje	9
Transparenca	10
Gabimet dhe jokonsistenca në vendimmarrje	12
Tenderët me çmim jonormalisht të ulët	12
Bindja e Autoritetit Kontraktues kur kërkon sqarime nga OE	13
Vlerësimi i tenderit si jonormalisht i ulët e drejtë (diskrecion) e Autoritetit Kontraktues	13
Çmimi jonormalisht i ulët në tenderët me poentim të çmimit	14
Kontradiktat në arsyetime brenda një vendimi	15
Aprovimi i pjesshëm i ankesës vetëm për të mos konfiskuar tarifën	15
Aprovimi i ankesave për tender të anuluar nga OSHP	16
Aprovimi i ankesës për OE të papërshtatshëm sipas nenit 65 të LPP-së	18
OE në Listë të Zezë, OSHP aprovon ankesën	20
OSHP “ngatërron” kompanitë në Listë të Zezë	21
Gabimet e ekspertëve shqyrtues / caktimi i ekspertëve jokompetent	22
Rekomandime:	24

Shkurtesat

AK	Autoriteti Kontraktues
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
KRPP	Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik
LPP	Ligji për Prokurimin Publik
OE	Operatori Ekonomik
OSHP	Organi Shqyrtues i Prokurimit
RrUOPP	Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ i Prokurimit Publik



Hyrje

Një kompani e cila pretendon se është shpallur e papërgjegjshme apo që ka kritere diskriminuese në një aktivitet të prokurimit nga një autoritet publik, në kundërshtim me legjislacionin dhe praktikën e prokurimit publik, duhet të ketë një mënyrë të ankimimit. Në Kosovë kompanitë e kanë Organin Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) që është e mandatuar t'i mbrojë ato nga vendimet e paligjshme të autoriteteve kontraktuese. Kompanitë së pari ankohen direkt te autoriteti kontraktues si nivel i parë i ankimimit, por ato ankesa në shumicën e rasteve refuzohen dhe shpresa e kompanive ankuese është në OSHP.

Demokraci Plus (D+) monitoron seancat e hapura të OSHP-së që nga viti 2016. Përmes raporteve të kaluara dhe këtij aktual, D+ synon që të përmirësojë cilësinë e vendimmarrjes së OSHP-së, në mënyrë që vendimet të merren sa më shpejtë që është e mundur dhe të jenë sa më të drejta për palët. Po ashtu, D+ angazhohet që OSHP t'i arsyetojë më mirë vendimet e saj, në mënyrë që një vendim të mos i shërbej thjeshtë një pale në proces, por të përbëjë edhe një precedent i cili shërben si udhëzues për rastet e ardhshme.

Në pesë raporte të monitorimit, D+ ka gjetur se problemi më i madh është joksistenca në vendimmarrje, kjo pasi që për rastet e ngjashme OSHP në shumë raste kishte vendosur në mënyrë të ndryshme. Mospërdorimi i databazës së brendshme ka bërë që OSHP të ketë shumë probleme me konsistencë të vendimeve. Në fakt kjo gjetje është përsëritur në secilin raport të D+ dhe kjo tregon që OSHP nuk është përmirësuar sa duhet sa i përket konsistencës në vendimmarrje. Përveç kësaj, praktika aktuale ku një kompani ankohet, OSHP në rast se gjen ankesën e bazuar e kthen tenderin në rivlerësim në vend se të marr vendim meritore, e përsëri ka ankesa në procedurë nuk arrin qëllimin e ligjit për prokurim efikas. Rreziku i sistemit aktual është që nxit kompanitë të ankohen vazhdimisht dhe e ngadalëson procedurën e prokurimit në atë formë që i rrezikon në tërësi kontratat publike.

Kjo praktikë ka ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e qytetarëve pasi që e vonon dhe vështirëson ofrimin e shërbimeve për qytetarët duke shkaktuar vështirësi në jetën e tyre. D+ ka gjetur se një ankesë në OSHP, e vonon nënshkrimin e kontratës mesatarisht për tetë muaj. Mirëpo ka raste ku për një tender as pas katër vitesh në OSHP nuk është arritur që të zgjedhet fituesi i kontratës¹.

Problem tjetër mbetet lista e zezë joefektive. Me praktikën aktuale, një kompani mund të diskualifikohet nga prokurimi për një periudhë të caktuar nga OSHP, të dënohen pronarët e saj dhe e njëjta mund të marrë pjesë prapë në tender. Mungon një sistem i teknologjisë së informacionit ku këtyre kompanive do të ju bllokohej qasja në sistem të e-prokurimit. Interpretimi që OSHP i bën ligjit aktual është se një kompani nuk diskualifikohet nëse ajo shkel kushtet e kontratës ose tërhiqet pasi zgjedhet fituese. Në një rast OSHP ka aprovuar ankesën e një kompanie, edhe pse ajo ishte konstatuar se pronarin e ka të dënuar për mashtrim dhe falsifikim, në një vendim të mëhershëm të OSHP-së. Është shumë me rëndësi që kompanitë e dënuara për falsifikim dhe mashtrim të mos lejohen të marrin pjesë në tenderë pasi kjo e zvogëlon besimin e kompanive tjera që ato do të mund kontrata në mënyrë të ndershme, kur e din që ka gjasa që një kompani tjetër që ka falsifikuar ndonjë dokument të fitojë kontratë.

¹ Tenderi për ndërtimin e ujësjellësit për disa fshatra të Dragashit është që katër vite me në OSHP

Përmbledhje

Ky raport shqyrton vendimet dhe praktikën e OSHP-së për të vlerësuar se sa efektive kanë qenë masat të cilat janë ndërmarrë dhe sa ka qenë e paanshme OSHP-ja në ndarjen e drejtësisë për palët.

Sikurse në gjetjet e raporteve paraprake të D+, edhe tek ky raport gjetjet tregojnë për mungesë të konsistencës ndërmjet një numri të vendimeve të OSHP-së, të cilat bien në kundërshtim me vendimet paraprake e ku pretendimet ankimore të ankuesve janë të njëjta. OSHP nuk duket se ka praktikuar ndonjë metodologji të krahasimit të vendimeve paraprake, në rastin e trajtimit të ankesave. Nëse kjo do të praktikohet, me gjasë edhe numri i vendimeve jokonsistente do zvogëlohet. Në vazhdimësi, D+ ka theksuar nevojën për standardizim më të madh të vendimeve të OSHP-së, në atë mënyrë që një vendim të jetë i arsyeshëm dhe i parashikueshëm nga palët, për shkak të ekzistimit të precedentit.

Numri i ankesave në vitin 2020 ka shënuar rritje të madhe, me 203 ankesa më shumë të dorëzuara sesa në vitin 2019. Trendi i njëjtë i ankesave pritet të jetë edhe në vitin 2021. Kjo përbën një rritje prej 20.7% në volumin e punës së OSHP-së, e cila deri më 31 mars 2021 ka funksionuar me kapacitete minimale, pasi që vetëm tre nga pesë anëtarë sa duhet t'i ketë OSHP sipas ligjit, kanë ushtruar funksionin, pasi të tjerëve u kishte përfunduar mandati.

OSHP ka aprovuar disa ankesa të kompanive që vetë i ka vendosur në Listë të Zezë. Në të dy raste, ankesa është aprovuar për të njëjtin tender për të cilin kompania është futur në Listë të Zezë.

Problem madhor është aprovimi i pjesërishtëm i ankesave në mënyrë që mos të konfiskohet tarifa e ankesës. D+ ka gjetur se OSHP gjatë vitit 2020 dhe 2021 ka aprovuar pjesërisht ankesën në 104 raste, ndërsa të gjitha pretendimet ankimore në ankesë janë refuzuar. Me këtë veprim OSHP ka dëmtuar buxhetin e Kosovës për 246,822 euro.

Problem tjetër mbetet se si OSHP i trajton ankesat për tenderë me çmime jonormalisht të ulëta. Paneli shqyrtues ka përdorur katër arsyetime të ndryshme duke e bërë të pamundur parashikimin në vendimmarrje në të tilla raste.

Problem tjetër janë rekomandimet e gabuara që në disa raste kanë dhënë ekspertët. Paneli duke mos pasur njohuri të duhura në fusha të caktuara, në disa raste vendimin e merr duke u bazuar tërësisht në rekomandimet e ekspertëve, të cilët në raste të caktuara kanë dhënë rekomandime të gabuara.

OSHP gjatë vitit 2020 dhe 2021

Demokrasi Plus (D+) në periudhën 1 janar 2020 deri më 31 mars 2021 ka bërë monitorimin e vendimeve të OSHP-së. Për shkak të pandemisë COVID-19 shumica e seancave për një kohë nuk janë mbajtur fare fillimisht, e pas një kohe janë mbajtur online përmes platformës Zoom. Brenda kësaj periudhe janë marrë 1520 vendime. Nga monitorimi i seancave, vendimeve të panelit, ekspertizave dhe ankesave, D+ ka gjetur se OSHP për këtë periudhë ka marrë këto lloj vendimesh:

Nga 1520 vendime, në favor të operatorëve ekonomik ankues (OEA) janë 841 sosh, në 26 raste janë tërhequr ankesat, në 51 raste paneli ka nxjerrë njoftim dhe 601 vendime janë vërtetuar vendimet e Autoriteteve Kontraktuese (AK). Në 26 vendime që janë pro OEA-ve, OSHP ka dhënë edhe urdhëresë për mosrespektim të vendimeve paraprahe nga autoritetet kontraktuese (AK).

Ekspertët shqyrtues kanë dhënë rekomandim në favor të OEA-ve në 879 raste, ndërsa rekomandim kundër OEA-ve në 545 raste.

Ankesat e OE janë kundër njoftimit për kontratë, njoftimit për dhënie të kontratës dhe njoftimit për anulim të tenderit, me numrin më të madh të ankesave kundër njoftimit për dhënie të kontratës. Megjithatë ka shumë raste kur OE ankohen kundër njoftimit për dhënie por në ankesë ka shumë pika që kanë të bëjnë me kriteret e tenderit për të cilat OE duhet të ankohen kundër njoftimit për kontratë.

Në përgjithësi vendimet e panelit dhe rekomandimet e ekspertëve nuk përputhen në 381 raste ose 26.4%. Në 841 vendime që janë në favor të kompanive ankuese, eksperti ka dhënë rekomandim të kundërt në 191 raste ose 22.7% të tyre. Në 601 vendime të panelit që kanë qenë kundër kompanive ankuese, ekspertët kanë rekomanduar ndryshe në 190 raste ose 31.6% të tyre.

Roli i OSHP-së në mosefikasitet në prokurim publik

Në OSHP vazhdon praktika që të ketë disa herë ankesa për tenderë të njëjtë. Kësaj shtate i kontribuon praktika e OSHP-së që të kthejë tenderët në rivlerësime të panevojshme. Kësaj i kontribuon edhe praktika e mosshqyrtimit të të gjithë ofertave. Një shembull ilustrues është situata kur kompania A ankohet kundër kompanisë B e cila është rekomanduar për kontratë, ankesa aprovohet e tenderi kthehet në rivlerësim. Pas rivlerësimit AK zgjedh fitues kompaninë A, ndërsa tani kompania B ankohet kundër kompanisë A. Një praktikë e tillë vonon shumë dhënien e kontratës, me pasojë që qytetarët mbesin pa punët dhe shërbimet që janë paraparë.

D+ ka përdorur platformën oshp.dplus.org dhe e-Prokurimin për të nxjerrë të dhënat të cilat tregojnë se 1479 ankesa të pranuar gjatë vitit 2020 dhe tre muajt e parë të vitit 2021 janë vetëm për 583 tenderë unikë. Kjo nënkupton që për një tender ka pasur ankesa nga disa OE dhe disa herë me radhë. Nga 583 tenderë, janë nënshkruar vetëm 361 kontrata, me një

kohëzgjatja mesatare prej 157 ditësh që data e njoftimit për kontratë e deri në datën e nënshkrimit të kontratës. Ndërsa për 113 tenderë që kanë pasur më shumë se një rund të ankesave (pra tenderi është kthyer së paku një herë në rivlerësim dhe përsëri ka pasur ankesa) kontrata është nënshkruar për mesatarisht pas 255 ditësh. Për dallim, për tenderët në të cilat nuk ka fare ankesa, kontrata nënshkruhet mesatarisht pas 54 ditësh. Shqetësues është fakti që 173 tenderë janë anuluar pas mesatarisht 130 ditësh. Ndërsa 49 tenderë janë ende pa rezultat për shkak që kanë ankesa aktive dhe si pasojë e mungesës së bordit të OSHP-së nuk kanë mundur të zgjidhen.

Pasi në OSHP zakonisht ankesat janë për tenderë me vlera të mëdha, shumë investime kapitale të rëndësishme shtyhen për muaj si pasojë e ankesave. Më problematik janë tenderët që kanë ndikim sezonal, p.sh. një tender për furnizim me dru do të kishte shumë probleme nëse ankesat do ta shtynin nënshkrimin e kontratës pasi të fillojë dimri. Njëjtë është për kontratat për mirëmbajtje dimërorë të rrugëve, të cilat si pasojë e ankesave dhe mungesës së kontratës mund të rrezikohet jeta e qytetarëve. Një shembull që dëshmon jo efikasitetin e praktikës së zgjidhjes së rasteve në OSHP është tenderi i Komunës së Prishtinës për furnizim me pajisje të teknologjisë informative për institucionet arsimore. Kontrata është nënshkruar pas 501 ditësh dhe pas pesë rundeve të ankesave në OSHP. Si pasojë komuna nuk ka mundur të shfrytëzojë pajisjet për gjysmën e dytë të vitit shkollor 2019/2020 dhe tërë vitin shkollor 2020/2021. Kur merret parasysh që gjatë kësaj Kosova është përballur me pandeminë COVID-19, pamundësia për të nënshkruar kontratën për një kohë të gjatë i ka dëmtonur nxënësit.

Të gjitha të dhënat më lartë tregojnë se OSHP duhet të marrë kompetencën që të shqyrtojë të gjitha ofertat njëherësh dhe të vendosë se cila kompani duhet të fitojë kontratën. Kjo praktikë do të lejonte që të ketë vetëm një rund të ankesave, dhe rrjedhimisht të shkurtrohet koha mesatare nga data e njoftimit për kontratë e deri në datën e nënshkrimit të kontratës.

Vonesat në vendimmarrje

Pas pranimit të ankesës OSHP ka 34 ditë² kohë për të marrë vendim dhe për ta publikuar të njëjtin në uebfaqe. Gjatë vitit 2020 dhe në tre muajt e parë të vitit 2021, krahasuar me vitet e kaluara, është shkurtuar koha mesatare për vendimmarrje. Kjo ka ndodhur për shkak të pandemisë COVID-19 e ku nuk janë mbajtur një numër i madh i seancave, gjë që ka ndikuar që të zvogëlohet koha mesatare.

² Sipas LPP, eksperti ka shqyrtues ka 10 ditë kohë për të shqyrtuar ankesën, AK dhe OE kanë 4 ditë kohë për të dhënë përgjigje në ekspertizë, paneli shqyrtues ka 15 ditë kohë për të marrë vendim, dhe 5 ditë për të publikuar vendimin, që gjithsej janë 34 ditë.




Tabela 1: Koha mesatare për vendimmarrje gjatë pesë viteve të fundit

Transparenca

Uebfaqja e re e lansuar në dhjetor 2019 e ka rritur ndjeshëm nivelin e transparencës. Në uebfaqen e re tanimë publikohen edhe ankesat e plota (në të kaluarën publikohej vetëm faqja e parë e ankesës) dhe raportet e ekspertëve shqyrtues. Megjithatë vendimet ende publikohen në format të skenuar që pamundëson kërkimin në tekst dhe që dokumenti të lexohet nga kompjuteri. OSHP duhet të përdorë praktikën e KRRP-së, ku vetëm faqja ku duhet nënshkrimi dhe vula është e skenuar, ndërsa pjesa tjetër është dokument, në të cilin mund të kërkohet.

Mirëpo, edhe pse publikimi i ankesave në formë të plotë dhe të raportit të ekspertëve shqyrtues është bërë i detyrueshëm ende ka mungesa në disa raste. Raportet e ekspertizës, në shumë raste nuk publikohen dhe është e vështirë të kuptohet se kush ka qenë eksperti që ka shqyrtuar lëndën.

Në uebfaqen e vjetër data e ngarkimit të dokumenteve merrej nga sistemi, ndërsa në uebfaqen e re është lënë mundësia që data të caktohet nga personi që ngarkon dokumentet. Prandaj në disa raste ka ndodhur që data e vendimit të jetë më e vjetër se data e ankesës, që logjikisht nuk ka mundësi të ndodhë kështu. Kjo mund të jetë gabim teknik, por për të hequr çdo dyshimet, duhet që data e ngarkimit të dokumenteve të merret nga sistemi automatikisht, gjë që ulë edhe mundësitë e çfarëdo keqpërdorimi.

Uebfaqja e re ka përmirësuar dukshëm mundësinë për të gjetur rastet në bazë të filtrave të ndryshëm. Tani rasti mund të kërkohet me numër të protokollit, numrit të prokurimit apo edhe titullit të tenderit. Gjithashtu në mënyrë automatike gjenerohen raportet me grafikone, për të parë më lehtë vendimmarrjen e OSHP-së.

Një nga problemet më të mëdha në uebfaqen e vjetër ishte me vendimet për futje në Listë të Zezë, të cilat grumbulloheshin së bashku me vendimet për ankesa. Nëse një autoritet kontraktues do të dëshironte ta shihte se cilat kompani janë në Listë të Zezë në një periudhë të caktuar, do ta kishte pothuajse të pamundur ta gjente. Tani në uebfaqen e re, Lista e Zezë është kategori e veçantë, në të cilën listohen kompanitë të cilat janë në Listë të Zezë dhe ato

të cilat kanë qenë më herët. Kjo e ka lehtësuar tej mase punën e autoriteteve kontraktuese, të cilat gjatë vlerësimit të ofertave e kanë shumë të lehtë që të shohin se mos ndonjë ofertues gjendet në Listë të Zezë. Përsëri kjo nuk zëvendëson nevojën që edhe platforma e e-prokurimit ti suspendojë llogaritë e këtyre operatorëve apo të ngris alarmin për AK se kompania është në Listë të Zezë.



Gabimet dhe jokonsistenca në vendimmarrje

Shumë ankesa kanë ngjashmëri mes vete për sa i përket pretendimeve ankimore. Kjo pasi që shumë institucione kryejnë veprime të kundërligjshme që janë të përsëritura edhe nga institucionet e tjera. Gjatë pesë viteve të monitorimit të OSHP-së, D+ ka gjetur se pretendimet ankimore përsëriten nëpër shumë ankesa. Nga të dhënat e mbledhura nga D+, do të ishte mjaftë e lehtë për OSHP që të merrte vendime konsistente, megjithatë një gjë e tillë nuk po ndodhë. Vendimet jokonsistente vazhdojnë të jenë pjesë e përditshme e vendimeve të OSHP-së. Mirëpo pse ndodh që për një pretendim ankimor të ketë vendime të ndryshme nga OSHP? Arsyet e jokonsistencës mund të jenë nga më të ndryshmet duke filluar nga neglizhenca e deri te mungesa e profesionalizimit.

Në pjesën në vazhdim paraqiten raste të vendimeve jokonsistente për disa çështje. Jokonsistenca ka ndikime negative në shumë dimensione duke përfshirë krijimin e pasigurisë juridike në prokurim publik, humbjen e besimit të palëve në OSHP dhe rritjen e dyshimeve për anësi në trajtimin e lëndëve nga ekspertët dhe paneli.

Tenderët me çmim jonormalisht të ulët

Një nga pretendimet më të shpeshta të OE që ankohen në OSHP është për tenderët me çmim jonormalisht të ulët apo te disa pjesë të tenderit që kanë çmime të tilla. OSHP është organi i cili do të duhej të merrte një vendim përfundimtar dhe konsistent në lidhje me këtë problem madhor. Sipas nenit 61 të Ligjit për Prokurim Publik (LPP), cilësimi se a ka dorëzuar një operator ekonomik tender jonormalisht të ulët bëhet nga autoriteti kontraktues. Palët e pakënaqura e kanë mundësinë të ankohen në OSHP e cila nuk e ka një qëndrim konsistent rreth këtij problemi. Çështja kontestuese është se a lëshohet ose jo OSHP në vlerësimin e çmimeve nëse janë në përputhje me ato të tregut apo kjo është e drejtë vetëm e autoritetit kontraktues. Sipas nenit 61 të LPP-së një tender mund të cilësohet si jonormalisht i ulët nëse kalkulohet sipas formulës që gjendet në nenin 3.1 Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët të miratuara nga Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik (KRPP). Formula për të llogaritur çmimin jonormalisht ulët është:

- çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm;
- çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët;
- janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë.

Por sipas nenit 3.2 të kësaj rregulloreje, një tender mund të cilësohet si jonormalisht i ulët edhe për arsye tjera. Megjithatë në të dy rastet tenderi nuk mund të refuzohet pa kërkuar

sqarime nga ofertuesi për çmimet e ofruara. Nëse AK pajtohet me shpjegimet atëherë e pranon ofertën, nëse jo, tenderi refuzohet si jonormalisht i ulët. OSHP nuk ka një qëndrim të njëjtë se a është përgjegjësi e AK-së vlerësimi i çmimeve të tenderit, a duhet të përdoret formula apo jo dhe a duhet të lëshohet OSHP në vlerësim se shpjegimi i ofruar nga ofertuesi është bindës apo jo.

D+ ka gjetur dhjetëra vendime jo konsistente ku OSHP nuk përdor standardin e njëjtë. Edhe në raportet e kaluara të D+ është identifikuar kjo dukuri, dhe OSHP nuk ka ndërmarrë veprime për të rritur konsistencën në vendimmarrje sa i përket tenderëve me çmim jonormalisht të ulët. Në vijim janë analizuar disa vendime ku OSHP është në kundërshtim me vendimet e saj.

Bindja e Autoritetit Kontraktues kur kërkon sqarime nga OE

Autoriteti kontraktues nëse e vëren që ndonjë tenderi ose një pjesë e tij ka çmime jonormalisht të ulëta kërkon sqarime nga operatori ekonomik. Nëse AK bindet nga sqarimet atëherë vazhdon me vlerësimin e ofertës dhe nuk e cilëson si tender jonormalisht të ulët. Nëse AK nuk bindet nga sqarimet e OE, atëherë oferta e OE cilësohet si e papërgjegjshme për shkak që ka çmime jonormalisht të ulëta. Në një pjesë të madhe të vendimeve OSHP për këtë pikë zakonisht mban anën e AK. Mirëpo në disa raste ka marrë vendim të kundërt.

Në vendimin [626/20](#)³, paneli shqyrtues nuk e aprovoi pretendimin e OE ankues ARF në lidhje me çmimet e ofertës së OE të rekomanduar, Focus Print. ARF pretendoi se Focus Print ka çmime jonormalisht të ulëta në disa artikuj. AK kishte kërkuar sqarime nga Focus Print dhe ishte bindur nga sqarimet e ofruara. Në vendim, paneli shqyrtues u arsyetua se pretendimi i ARF është i pabazuar për arsye se AK ka kërkuar sqarime nga Focus Print dhe është bindur nga sqarimet e dhëna.

Në një vendim të [tjetër](#)⁴ të marrë dy javë më vonë, paneli shqyrtues tha së oferta e OE Multi Business Group nuk mund të cilësohet se ka çmime jonormalisht të ulëta për shkak se çmimi total i ofertës është shumë i afërt me atë të OE të rekomanduar për kontratë. Mirëpo, AK ka vepruar siç e kërkon ligji. AK ka dyshuar në çmimin e OE ankues dhe ka kërkuar sqarime. AK nuk është bindur në sqarimet e dhëna dhe ka e ka cilësuar ofertën si të papërgjegjshme.

Këto janë vetëm dy raste se si OSHP ka rënë në kundërshtim me vetveten, mirëpo raste të ngjashme ka në vendimet [564/20](#), [573/20](#), [964/20](#) ku OSHP nuk ka vlerësuar bindjen e AK. Ndërsa ka vendime tjera ([462/20](#)) ku OSHP ka vlerësuar bindjen e AK. Në këtë ankesë, AK kishte kërkuar sqarime për OE ankues në lidhje me disa çmime të disa artikujve. OE kishte dhënë sqarimet e saj, mirëpo AK nuk ishte bindur dhe kishte refuzuar ofertën. Përderisa në tri vendimet më lartë, OSHP nuk është lëshuar të vlerësoje se a është bindur AK në shpjegimet e OE, në këtë vendim OSHP nuk e merr parasysh se AK nuk është bindur nga shpjegimet e dhëna nga OE ankues.

Vlerësimi i tenderit si jonormalisht i ulët e drejtë (diskrecion) e Autoritetit Kontraktues

Siç është cekur më lartë për t'u cilësuar një tender si jonormalisht i ulët duhet disa hapa. Hapi i parë është kur AK e "vëren/sheh" që një tender ka çmime jonormalisht të ulëta. Mirëpo ka raste edhe kur edhe pse qartazi vërehet që një ofertë ka çmime tejet të ulëta

³ Organi Shqyrtues i Prokurimit. Vendimi 626/20, faqe 13. 2020.

<https://oshp.rks-gov.net/sq/ProcurementActivities/Download/9f4b29c3-2802-eb11-b591-005056ba09d5>

⁴ Organi Shqyrtues i Prokurimit. Vendimi 664/20, faqe 8. 2020.

<https://oshp.rks-gov.net/sq/ProcurementActivities/Download/e98eadf2-530d-eb11-b591-005056ba09d5>

(p.sh. ora e punës, një cent), AK vendos të mos e cilësojë tenderin si jonormalisht të ulët. Në të tilla raste, shumë OE janë ankuar me pretendimin se OE i rekomanduar për kontratë ka çmime jonormalisht të ulëta. Edhe në vendimet për këto ankesa ka jokonsistencë nga OSHP.

Në vendimin [954/20](#) paneli u arsyetua se⁵: “...se vlerësimi i çmimi sipas dispozitave të nenit 61 të LPP-së është e drejtë e autoritetit kontraktues dhe në rastin konkret AK-ja, nuk ka vërejtur se ka çmime jonormalisht të ulëta”

Në këtë rast, OE ankues Ejona SH.P.K pretendoi se oferta e OE të rekomanduar, Ekotermika, është për 25% më e ulët se vlera e parashikuar e tenderit.

Megjithatë në një vendim të mëhershëm, 353/20, paneli shqyrtues [aprovo](#)⁶ pretendimin e OE ankues NNP Ĕenda se OE i rekomanduar për dy artikuj ka çmim jonormalisht të ulët. Bazuar në vendimet e kaluara, OSHP për këtë pretendim do të duhej të thoshte që është e drejtë e AK të vlerësojë çmimet.

Çmimi jonormalisht i ulët në tenderët me poentim të çmimit

Procedura e poentimit të çmimit është një procedurë e cila përdoret në prokurimin publik për rastet kur autoriteti kontraktues “nuk e di” sasinë e artikujve që do të porosisë, dhe për këtë qëllim secili artikull në listë të çmimeve e ka sasinë “1”. Gjatë zbatimit të kontratës porositë bëhen varësisht prej nevojave që dalin. Lista e çmimeve ndahet në disa kategori dhe secilës prej tyre iu jepet një peshë e caktuar në totalin prej 100%. Poentimi i çmimeve shërben vetëm për të vlerësuar ofertat, ndërsa kontrata zbatohet me çmimet për njësi. Për këta tenderë nuk mund të aplikohet formula për përlogaritjen e çmimit jonormalisht të ulët, pasi çmimi është i poentuar. Megjithatë për këtë lloj tenderësh mund të përdoret neni 3.2 i formularit B57 i cili thotë⁷: 3.2 Kur tenderët duken të jenë jo-normalisht të ulët për arsye të tjera nga ato të parashikuara në paragrafin 3.1 të këtyre rregullave, autoritetet kontraktuese mund të vlerësojnë besueshmërinë e tenderëve të tillë dhe rrjedhimisht të kërkojnë shpjegime në përputhje me paragrafët e mëposhtëm dhe nenin 61 të LPP-së.

Pikërisht ky nen mund të përdoret për të cilësuar si jonormalisht të ulëta çmimet për artikull, kur përdoret procedura me poentim të çmimit. Kjo pasi pagesa e faturave në këto kontrata bëhet për çmimet e papoentuara, të cilat janë çmimet reale të kontratës. OSHP gabimisht në vendimin [590/19](#) ka vlerësuar se për tenderët me poentim nuk mund të aplikohet Rregullorja për tenderë jonormalisht të ulët. Edhe pse ky arsyetim është i gabuar, megjithatë OSHP për një kohë në disa vendime e ka përdorur si arsyetim sa herë që ka qenë pretendim. Një arsyetim i gabuar do të ishte më i drejtë nëse do të ishte i njëjtë për të gjitha ankesat. Megjithatë, paneli shqyrtues në së paku tri vendime tjera ka shqyrtuar pretendimin për çmim jonormalisht të ulët edhe pse tenderi ka qenë me poentim. OSHP i ka dhënë të drejtë Autoritetit Kontraktues në vendimin [352-358-359/20](#)⁸, OSHP ktheu tenderin në rivlerësim edhe pse tenderi ishte me poentim dhe pretendimet ishin për çmime jonormalisht të ulëta. Po të përdorej arsyetimi i vendimit 590/19, atëherë OSHP është

⁵ Organi Shqyrtues i Prokurimit. Vendimi 954/20, faqe 3. 2021.

<https://oshp.rks-gov.net/sq/ProcurementActivities/Download/dd8c4282-7335-eb11-b593-005056ba09d5>

⁶ Organi Shqyrtues i Prokurimit. Vendimi 353/20, faqe 9. 2020.

<https://oshp.rks-gov.net/sq/ProcurementActivities/Download/fadf3897-8ac2-ea11-b58d-005056ba09d5>

⁷ KRPP. B57 Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët- Verzion i korrigjuar. 2016.

<https://dpl.us/b57>

⁸ Organi Shqyrtues i Prokurimit. Vendimi 352-358-359/20, faqe 13-14. 2020

<https://oshp.rks-gov.net/sq/ProcurementActivities/Download/119c3bba-90c2-ea11-b58d-005056ba09d5>

dashur të vendosë sipas standardit se çmimet e poentuara nuk mund të cilësohen si jonormalisht të ulëta. E veçanta e vendimit 352-358-359/20 është që ka të bëjë për tender për mirëmbajtje të veturave. Për këtë lloj të tenderëve gjithmonë përdoret procedura e poentimit të çmimit dhe zakonisht çmimet janë jonormalisht të ulëta në shumë artikuj. Për tender të njëjtë, në vendimi 1054/20, OSHP [refuzoi](#)⁹ pretendimin ankimor të OE DPT Autopjesë Buqa me arsyen se nuk mund të krahasohen çmimet me OE të rekomanduar, pasi tenderi është me poentim të çmimit. Paneli citoi vendimin 590/19 për të mbështetur arsyetimin e saj, vendim të cilin e ka shkelur në tri raste më lartë. Nga të dhënat më lartë vërehet që paneli shqyrtues kur do ta citojë një vendim paraprak që ka marrë është në gjendje ta bëjë këtë.

Kontradiktat në arsyetime brenda një vendimi

Përveç vendimeve jokonsistente, paneli shqyrtues në disa raste ka edhe kontradikta në arsyetimet brenda një vendimi. Në vendimin [903/19](#)ⁱ, OSHP aprovoi ankesën e konsorciumit Millenium Konstruktion & Anuar kundër OE të rekomanduar për tri lote të ndryshme. Paneli në një rast të paprecedent i shpalli drejtpërdrejt si të papërgjegjshëm ofertat e OE të rekomanduar për shkak se plotësohej kushti sipas formulës për çmim jonormalisht të ulët.

Në faqen 13 të vendimit, paneli shkruan se oferta e OE të rekomanduar për lot 2 duhet të refuzohet si tender jonormalisht i ulët.

Sipas nenit 61 të LPP, asnjë OE nuk mund të eliminohet në mënyrë automatike pa kërkuar sqarime. Në rast se pas ofrimit të sqarimeve AK nuk bindet, atëherë oferta mund të eliminohet. Mirëpo në faqen e fundit të vendimit, paneli thotë:

“Paneli shqyrtues obligon autoritetin kontraktues që gjatë rivlerësimit të marrë për bazë nenin 3.1 të Rregullave për Tenderët Jonormalisht të ulët dhe njëkohësisht t’i trajtojë në mënyrë të barabartë të gjithë ofertuesit”

Ky arsyetim është në kundërshtim me arsyetimin e dhënë pak më lartë. Vetë OSHP nuk ka respektuar nenin 61 kur i shpalli ofertat e OE të rekomanduar si të papërgjegjshme, ndërsa obligoi AK të zbatojë nenin 61 (Rregullorja për tenderë jonormalisht të ulët buron nga neni 61). Ky vendim kontradiktor mund të krijojë huti të AK dhe të OE të cilët janë shpallur të papërgjegjshëm. Paneli pikërisht citon nenin 3.1 të Rregullores për tender jonormalisht të ulët për t’i eliminuar tri oferta, ndërsa në fund të vendimit thotë të respektohet neni 3.1. Ky nen thotëⁱⁱ se autoritetet kontraktuese **do të kërkojnë** nga operatorët ekonomik **për të shpjeguar** çmimin e ofruar kur të plotësohen kushtet sipas formulës. Pra ky nen nuk i jep të drejtë OSHP-së që pa kërkuar shpjegim të shpallen të papërgjegjshëm ofertuesit.

Aprovimi i pjesshëm i ankesës vetëm për të mos konfiskuar tarifën

Çdo kompani që dëshiron të ankohet kundër një vendimi të autoritetit kontraktues duhet të paguajë një tarifë për tu ankuar në OSHP. Tarifa për një ankesë në OSHP mund të shkojë nga 100 deri në 5,000 euro. Sipas Rregullores së Punës së OSHP-së¹⁰, kur pretendimet ankimore në një ankesë janë të pabazuara, atëherë duhet të konfiskohet tarifa e ankesës.

⁹ Organi Shqyrtues i Prokurimit. Vendimi 1054/20, faqe 6. 2021.

<https://oshp.rks-gov.net/sq/ProcurementActivities/Download/d9c8511f-0c4a-eb11-b594-005056ba09d5>

¹⁰ Organi Shqyrtues i Prokurimit. Rregullorja e Punës, neni 31. 2020.

<https://oshp.rks-gov.net/sq/Documents/Download?Id=0d49ce49-afc2-eb11-b59b-005056ba09d5>

GJITHSEJT JANË 246,822 EURO, TË CILAT NUK JANË KONFISKUAR DHE ËSHTË DËMTUAR BUXHETI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS, PASI MJETET E KONFISKUARA DO TË DUHEJ TË DERDHEN NË BUXHET.

Tarifa nuk konfiskohet kur ankesa aprovohet në tërësi apo pjesërisht. Në vitin 2020 dhe në tre muajt e parë të vitit 2021, OSHP ka aprovuar pjesërisht ankesën dhe ka lënë në fuqi vendimin e autoritetit kontraktues në 376 raste. Mirëpo për 104 ankesa,

OSHP ka aprovuar pjesërisht ankesën, edhe pse të gjitha pretendimet ankimore ishin refuzuar. Në vitin 2020 tarifa është dashur të konfiskohet për 71 ankesa nga 227 (26.6%) ankesa që janë aprovuar pjesërisht dhe është lënë në fuqi vendimi i AK ndërsa vetëm për tre muajt e parë të vitit 2021, 34 ankesa nga 65 (52%) janë aprovuar pjesërisht, të cilat është dashur të refuzohen. Këtu vërehet një trend në rritje gjatë vitit 2021, ku edhe pse vetëm për tre muajt, numri i ankesave të cilat është dashur të refuzohen është gati sa gjysma e atyre të vitit 2020.

Në 59 nga 104 ankesa, ekspertët shqyrtues kanë rekomanduar që të refuzohet ankesa. Përderisa në tërësi mospërputhja në mes vendimit të panelit shqyrtues dhe rekomandimit të ekspertëve shqyrtues është 26.4%, këtu mospërputhja është 57%. Një e dhënë tjetër është se në përgjithësi ankesat që aprovohen pjesërisht edhe kur pretendimet refuzohen janë ato për tenderë me vlerë të madhe. Në 25 raste tarifa e ankesës ka qenë 5,000 euro, pra maksimumi i mundshëm sipas LPP.

Për të 104 ankesat, vendimi do të duhej të ishte që të refuzohet ankesa dhe të konfiskohet tarifa e ankesës.

Aprovimi i pjesshëm i ankesës vetëm që mos konfiskohet tarifa e ankesës nxit kompanitë që të dorëzojnë ankesa të pabaza dhe njëkohësisht rrit numrin e ankesave. D+ pret nga bordi i ri që të zbatohet Rregullorja e Punës së OSHP-së, pra kur të refuzohet pretendimet ankimore, ankesa të refuzohet dhe të konfiskohet tarifa e ankesës. Kjo do të ndikonte që të ulet numri i ankesave, pasi OE kur e dinë që ankesa do të refuzohet më shpesh do të hezitojnë të ankohen dhe të bllokojnë tenderët në OSHP.

Aprovimi i ankesave për tender të anuluar nga OSHP

Një nga vendimet që merr OSHP është anulimi i tenderëve. Kjo bëhet zakonisht kur asnjëri nga ofertuesit nuk është i përgjegjshëm. Pas anulimit të tenderit nga OSHP, autoriteti kontraktues e ka për obligim që të publikojë Njoftimin për Anulimin e Aktivitetit të Prokurimit në e-Prokurim. Mirëpo LPP i jep drejtë ankesë operatorëve ekonomik që të ankohen kundër këtij njoftimi.

OSHP në dy raste ka aprovuar ankesën e OE edhe pse më parë me vendim të OSHP-së është anuluar tenderin. Në vendimin për anulim të tenderit, thotë që kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa. Por si ka ndodhur që OSHP të kthejë në rivlerësim tenderin që e ka anuluar vetë? Kompania NNP Elektro u ankua kundër vendimit të Universitetit të Prishtinës (UP) për t'i dhënë kontratën OE Nart Group. OSHP, në vendimin [225/20](#)¹¹ vendosi

¹¹ Organi Shqyrtues i Prokurimit. Vendimi 225/20. 2020.

<https://oshp.rks-gov.net/sq/ProcurementActivities/Download/a412f9ac-1d91-ea11-b58c-005056ba09d5>

se ofertat e të dy OE janë të papërgjegjshme, dhe pasi nuk kishte oferta tjera vendosi që të anulohet tenderin.

Universiteti i Prishtinës, pas vendimit të OSHP-së, publikoi dokumentin B10 Njoftim për anulimin e aktivitetit të prokurimit. Arsyetimi i UP-së për anulim është bazuar në vendimin e OSHP-së dhe nenin 62 të LPP-së i cili thotë se kur nuk ka asnjë ofertë të përgjegjshme atëherë tenderi duhet të anulohet. Kundër këtij vendimi, kompania Nard

Paneli Shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës të cilat i ka pasur në dispozicion, si dhe në bazë të sqarimeve të ekspertit shqyrtues/teknik konsideron se tenderët e operatorëve ekonomik janë të papërgjegjshëm. Në mungesë të tenderëve të përgjegjshëm, autoriteti kontraktues **duhet ta anulohet këtij** aktivitet të prokurimit konform nenit 62 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
Nuhî Paçarizi

Figura 2: Arsyetimi i OSHP-së për të anuluar tenderin e UP-së

Group së pari u ankua tek autoriteti kontraktues, ku ankesa iu refuzua. Pastaj, kjo kompani u ankua në OSHP e cila e aprovoi ankesën. Gabimi i parë është se ankesa nuk është dashur të pranohet pasi tenderi veçse ishte anuluar nga OSHP. Megjithatë, ankesa u fut në shqyrtim, e ku eksperti shqyrtues me të drejtë rekomandoi që ankesa të refuzohet pasi tenderi ishte anuluar nga OSHP. Paneli shqyrtues këtë rekomandim nuk e mori parasysh, i cili në kontradiktë të madhe me vendimin paraprak, [në arsyetim](#)¹² thotë se anulimi i tenderit nga UP (Dokumenti B10 i përmendur më lartë) është bërë në kundërshtim me nenin 62 të LPP dhe ktheu tenderin në rivlerësim. Në vendimin paraprak OSHP vendosi që tenderi duhet të anulohet duke u mbështetur pikërisht në nenin 62.

Pas rivlerësimit, UP shpalli fituese kompaninë Nard Group. Kundër këtij vendimi, në OSHP u ankua NNP Elektro. Paneli Shqyrtues e aprovoi pjesërisht ankesën, mirëpo e la në fuqi vendimin e AK për dhënie të kontratës.

Për këtë aktivitet të prokurimit janë dorëzuar pesë ankesa. E gjithë kjo humbje kohë nuk do të kishte ndodhur po të ishin shqyrtuar ofertat e të dy kompanive. OSHP, për aprovim të ankesës [380/20](#)¹³ të OE Nard Group arsyetohet se UP nuk ka dhënë afat se kur duhet të dorëzohet vazhdimi i validitetit dhe sigurimit të tenderit. Zyrtari i prokurimi më 24 mars 2020 ka kërkuar që të zgjatet validiteti dhe sigurimi i tenderit, mirëpo nuk ka dhënë afat se kur duhet të bëhet kjo. Vetëm NNP Elektro është përgjigjur në kërkesë, ndërsa Nard Group, jo. Një nga pretendimet e NNP Elektro në ankesën 225/20 ka qenë pikërisht kjo, që Nard Group nuk ka vazhduar validitetin dhe sigurimin e tenderit. Se kërkesa e UP nuk ka afat për të dhënë përgjigje ka mundur të vërehet më herët nga eksperti dhe paneli shqyrtues.

OSHP me vendimin 380/20 ka rënë në kundërshtim me vendimin 225/20. OSHP ka mundur që të korrigjojë vendimin 225/20 dhe nuk do të kishte nevojë fare për ankesa tjera. Pranimi, shqyrtimi dhe aprovimi i një ankesë për një tender të anuluar nga vetë OSHP, është neglizhencë e madhe dhe joprofesionalizëm nga OSHP.

¹² Organi Shqyrtues i Prokurimit. Vendimi 380/20. 2020

<https://oshp.rks-gov.net/sq/ProcurementActivities/Download/88e3c696-96d8-ea11-b58f-005056ba09d5>

¹³ Organi Shqyrtues i Prokurimit. Vendimi 380/20. 2020

<https://oshp.rks-gov.net/sq/ProcurementActivities/Download/88e3c696-96d8-ea11-b58f-005056ba09d5>

Ky nuk është rast i izoluar pasi që njëjtë ka ndodhur edhe me një tender tjetër. OSHP, në vendimin për ankesën 132/20 [anuloi tenderin](#)¹⁴ me arsyen së OE ankues dhe ai i rekomanduar për kontratë janë të papërgjegjshëm. AK, zbatoi dispozitat e LPP dhe publikoi Njoftimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit. Pas këtij njoftimi, OE As Tech i cili ishte i rekomanduar për dhënie të kontratës herën e kaluar, u ankua në OSHP. Edhe në këtë rast ankesa nuk është dashur të shqyrtohet fare, pasi tenderi ishte anuluar më parë nga OSHP. Megjithatë paneli shqyrtues [refuzoi ankesën 249/20](#)¹⁵ dhe konfiskoi tarifën e ankesës. Mirëpo edhe pse është shqyrtuar, vendimi do të duhej të ishte që ankesa të hidhet poshtë si e palejuar pasi kompania As Tech është shpallur e papërgjegjshme në vendimin e kaluar. Praktika e OSHP-së që kur oferta e një OE shpallet e papërgjegjshme dhe ajo ankohet në të ardhmen për të njëjtin tender, atëherë ankesa hidhet poshtë si e palejuar. Në këtë rast OSHP në mënyrë të padrejtë ka konfiskuar tarifën e ankesës.

Rast tjetër i shqyrtimit të ankesës për tender të anuluar nga OSHP ka ndodhur për ankesën 622/20 të OE Lirimed. OSHP vendosi që tenderi të [anullohet](#)¹⁶ pasi oferta e Lirimed ishte e papërgjegjshme. Edhe në këtë rast, AK – Ministria e Shëndetësisë, veproi sipas LPP dhe publikoi Njoftimin për anulim të tenderit. Përsëri, Lirimed u ankua në OSHP, e cila për dallim nga vendimi 249/20, mori [vendim](#)¹⁷ që ankesa 910/20 të hidhet poshtë si e palejuar, duke mos konfiskuar tarifën e ankesës.

Përderisa vetë OSHP ka shqyrtuar ankesa për tenderë të anuluar, në vendimin [130/21](#), Paneli Shqyrtues anuloi tenderin që e kishte anuluar njëherë në vendimin [1031/20](#). Komuna e Vitisë nuk ka respektuar vendimin e OSHP-së, pasi pas Njoftimit për Anulim të Aktivitetit të Prokurimit ka shpallur fitues një OE. Për moszbatim të vendimit 1031/20 në lidhje me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i rrugës Viti-Kërbliq-Kaqanik- Faza e II (dytë)” KRPP i ka [revokuar](#) licencën e prokurimit, menaxherit të prokurimit të Komunës së Vitisë.

Shqyrtimi i ankesave për tenderë që janë anuluar nga vetë OSHP ka rrezik të kthehet në precedent të zakonshëm nëse bordi i ri i OSHP-së nuk ndërmerr masa për të ndaluar këtë praktikë. Specifikisht, duhet që çdo ankesë që dorëzohet në OSHP, gjatë shqyrtimit fillestar të saj, të kontrollohet se mos është dorëzuar ankesë për një tender të anuluar.

Aprovimi i ankesës për OE të papërshtatshëm sipas nenit 65 të LPP-së

Neni 65 i Ligjit për Prokurim Publik, ndër të tjera e ndalon pjesëmarrjen në tender apo ekzekutimin e kontratës nëse një operator ekonomik apo ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të kaluara:

3.1. është shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepre penale ose civile duke përfshirë praktikën e korrupsionit, larjen e parave, dhënien e mitos, avantazhe ose aktivitetet e ngjashme me ato të përshkruara në paragrafin 1. të nenit 130 të këtij ligji

¹⁴ Organi Shqyrtues i Prokurimit. Vendimi 132/20. 2020

<https://oshp.rks-gov.net/sq/ProcurementActivities/Download/44ccefce-7a72-ea11-b58c-005056ba09d5>

¹⁵ Organi Shqyrtues i Prokurimit. Vendimi 249/20. 2020

<https://oshp.rks-gov.net/sq/ProcurementActivities/Download/da474169-499b-ea11-b58d-005056ba09d5>

¹⁶ Organi Shqyrtues i Prokurimit. Vendimi 622-627/20. 2020

<https://oshp.rks-gov.net/sq/ProcurementActivities/Download/87410991-650c-eb11-b591-005056ba09d5>

¹⁷ Organi Shqyrtues i Prokurimit. Vendimi 910-913/20. 2020

<https://oshp.rks-gov.net/sq/ProcurementActivities/Download/8cbea1f6-0c3f-eb11-b594-005056ba09d5>

sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Kosovë ose në cilindo shtet, ose në çfarëdo marrëveshje ose konvente ndërkombëtare;

Pronari i kompanisë (i atëhershëm) i Linda SH.P.K. është dënuar në vitin 2016 për veprë penale, gjë që është vërtetuar edhe nga OSHP në vendimin 345/17¹⁸. Megjithatë i njëjti panel që e ka cilësuar si të papërshtatshme këtë kompani, ka aprovuar në tri raste ankesat e saj gjatë vitit 2020. Duke u bazuar në dispozitat e mësipërme të Nenit 65 të LPP kjo kompani nuk ka të drejtë të marrë pjesë në tender ose të ekzekutojë një kontratë. Kjo nënkupton që kjo kompani nuk ka të drejtë ta bëjë këtë prej vitit 2016 e deri në vitin 2026. Ky rast ka qenë i njohur për publikun dhe është raportuar në media, dhe si i tillë nuk do të duhej harruar nga paneli shqyrtues.

Megjithatë paneli shqyrtues në vendimin [274/20](#)¹⁹ aprovoi pjesërisht ankesën e konsorciumit ku bënte pjesë Linda SH.P.K. Paneli shqyrtues në arsyetim nuk e përmendi fare që kjo kompani nuk ka të drejtë të marrë pjesë në tenderë dhe të ekzekutojë kontrata publike. Pas rivlerësimit, përsëri u ankua Linda SH.P.K e as kësaj [radhe](#)²⁰ paneli shqyrtues nuk e pati parasysh që kjo kompani nuk ka të drejtë të fitojë tenderë. Megjithatë ankesa u aprovua vetëm pjesërisht, pasi paneli shqyrtues la në fuqi vendimin e Komunës së Prishtinës për t'i dhënë kontratën kompanisë Rexha.

Në vendimin [216/20](#)²¹, ankesa e OE Linda SH.P.K u aprovua pjesërisht kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit nga Komuna e Ferizajt dhe tenderi u kthye në rivlerësim. Linda SH.P.K kishte ofertuar si e vetme në këtë tender. Pas rivlerësimit, komuna shpalli fituese pikërisht kompaninë Linda me çmim 443,777.77 euro. Për më tepër në këtë tender të gjitha ofertave ju kishte skaduar validiteti. Këtu OSHP ka rënë në kundërshtim me vetveten pasi në disa vendime [tjera](#), në momentin që ofertave ju ka skaduar validiteti atëherë tenderi është anuluar nga OSHP.

Në vendimin [311-318/20](#)²², OSHP aprovoi pjesërisht ankesat e kompanive Limitproject & Mirusha Company & AK-Invest & Aksi Project dhe konsorciumit tjetër Olti Trasing & Sinani & Beni Dona, por la në fuqi vendimin e Komunës së Ferizajt për t'i dhënë kontratën me vlerë rreth 3.3 milionë euro konsorciumit B-Bardhi & Linda & Euro Infrastruktura. Edhe pse asnjëri nga OE ankues nuk ka pasur pretendim që OE Linda nuk ka të drejtë të fitojë kontratë, paneli shqyrtues është dashur të marrë vendim duke u bazuar në vendimin 345/17.

Aprovimi i ankesës së Linda SH.P.K në tri raste dhe një rast të lejohet që të fitojë kontratën tregon që paneli shqyrtues në rastin më të mirë tregon mungesë profesionalizimi dhe nuk konsultohet fare me vendimet paraprake e në rastin më të keq paneli e ka ditur që kësaj kompanie ju është mohuar e drejta për të fituar kontrata publike e megjithatë ia ka aprovuar ankesat. Shqetësues mbetet fakti që është pikërisht Komuna e Ferizajt e cila është dashur ta dijë rastin e kësaj kompanie, pasi së pari në media është zbuluar se në këtë

¹⁸ Organi Shqyrtues i Prokurimit. Vendimi 345/17. 2017.

http://arkivaoshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2017/345-17vendim_1.PDF

¹⁹ Organi Shqyrtues i Prokurimit. Vendimi 240/20. 2020.

<https://oshp.rks-gov.net/sq/ProcurementActivities/Download/Oead313c-fbae-ea11-b58d-005056ba09d5>

²⁰ Organi Shqyrtues i Prokurimit. Vendimi 594/20. 2020.

<https://oshp.rks-gov.net/sq/ProcurementActivities/Download/7f86b4d6-fd02-eb11-b591-005056ba09d5>

²¹ Organi Shqyrtues i Prokurimit. Vendimi 216/20. 2020

<https://oshp.rks-gov.net/sq/ProcurementActivities/Download/e4c4d15f-cf83-ea11-b58c-005056ba09d5>

²² Organi Shqyrtues i Prokurimit. Vendimi 311-318/20. 2020.

<https://oshp.rks-gov.net/sq/ProcurementActivities/Download/8dca76b6-eadb-ea11-b58f-005056ba09d5>

komunë ka fituar tender Linda SH.P.K përderisa pronari i saj ka qenë i dënuar për vepër penale. Rasti i kompanisë Linda SH.P.K ka shpërfaqur dështimin e të gjithë akterëve në prokurim publik duke përfshirë:

- Autoritetin kontraktues e cila është dashur të eliminojë ofertën e kompanisë;
- Gjykatën e cila lëshon certifikatë vetëm se kompania nuk është falimentuar gjatë dy viteve të kaluara dhe nuk është në likuidim. Ndërsa neni 65 i LPP-së përfshin një sërë kërkesash tjera, përfshirë dëshminë se OE ose drejtuesit e saj nuk kanë qenë të dënuar gjatë dhjetë viteve të kaluara. Vërtetimi që aktualisht lëshohet nga gjykata është pothuajse i pavlerë dhe gjysmak, duke e bërë kështu të pazbatueshëm nenin 65 të LPP-së.
- Organin Shqyrtues të Prokurimit e cila është dashur mos të aprovojë ankesat.

OE në Listë të Zezë, OSHP aprovon ankesën

Kompania D.SH. AMTelecommunication [është futur në Listë të Zezë](#)²³ (për periudhën 3 shtator 2020 deri më 2 mars 2021), për arsye se ka dhënë deklaratë të rreme duke falsifikuar një autorizim. Në të njëjtën periudhë, kjo kompani ishte ankuar për të njëjtin tender. Kompania D.SH. AMTelecommunication dorëzoi ankesë për tenderin e Universitetit të Prizrenit (UPZ) – Ukshin Hoti me titull “Furnizimi, montimi dhe funksionalizimi me pajisje dhe materiale përcjellëse të sistemit të vijueshmërisë në punë për stafin e Universitetit” më 6 gusht 2020. Eksperti shqyrtues dorëzoi ekspertizën më 26 gusht 2020 dhe rekomandoi që tenderi të kthehet në rivlerësim.

Në anën tjetër disa muaj më herët, më 28 maj 2020, UPZ ka bërë kërkesë në OSHP që kompania të futet në Listë të Zezë, për të njëjtin tender.

Paneli shqyrtues vetëm pesë ditë më vonë, më 8 shtator 2020, mori vendim që ankesa e kompanisë D.SH. AMTelecommunication të [aprovohet](#)²⁴ dhe tenderi të kthehet në rivlerësim. Arsyetimi i panelit shqyrtues është i njëjtë fjalë për fjalë me atë të ekspertit shqyrtues. Këtu duhet shtuar që raporti i ekspertit është dorëzuar para se OSHP të marrë vendim që kompania të futet në Listë të Zezë. OSHP siç vërehet nga datat e përmendura më lartë është vonuar shumë për të nxjerrë vendim për futje në Listë të Zezë. OSHP-së i janë dashur 99 ditë për të marrë vendim, përderisa koha mesatare e marrjes së një vendimi gjatë vitit 2020 ka qenë 35 ditë.

Diskualifikimi i kompanisë D.SH. AMTelecommunication e më pas aprovimi i ankesës së saj për të njëjtin tender dëmton profesionalizmin e OSHP-së. Arsyetimi i panelit do të duhej të ishte që ankesa refuzohet sepse kompania është futur në Listë të Zezë e jo të kopjohet raporti i ekspertit shqyrtues. Këtë dukuri D+ e ka evidentuar edhe [në raportet e kaluara](#)²⁵ ku edhe shpërfaqet një neglizhencë e Panelit Shqyrtues, ku në rastet që Paneli Shqyrtues pajtohet me raportin e ekspertizës, atëherë arsyetimi është i njëjtë, vetëm shtohet kjo pjesë e fjalisë në fillim “Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues...”.

²³ Organi Shqyrtues i Prokurimit. Vendimi 172/20. 2020.

<https://oshp.rks-gov.net/sq/Documents/Download?id=39767996-aaee-ea11-b590-005056ba09d5>

²⁴ Organi Shqyrtues i Prokurimit. Vendimi 564/20. 2020

<https://oshp.rks-gov.net/sq/ProcurementActivities/Download/e0c99595-2df7-ea11-b591-005056ba09d5>

²⁵ Demokraci Plus. Roli i OSHP-së në mosefikasitetin në prokurim publik. Faqe 37. 2019

<https://dpl.us/x38>

OSHP nuk mund të arsyetohet se ankesa është dorëzuar para se të merret vendimi për futje në Listë të Zezë pasi atëherë do të binte në kundërshtim me një vendim tjetër ku është vendosur ndryshe. OSHP ka futur në Listë të Zezë kompaninë Lirigzoni SH.P.K. më 19 nëntor 2019. Kjo kompani ishte ankuar për një tender më 21 tetor 2019. Në vendimin [728/19](#)²⁶ të datës 23 dhjetor 2019, OSHP ia refuzoi ankesën kompanisë (OSHP ka ngatërruar kompaninë, më poshtë do të lexoni më në detaje për këtë) me arsyen se është futur në Listë të Zezë. Kjo nënkupton që ankesa është refuzuar, edhe pse ankesa e OE është dorëzuar para se të futet në Listë të Zezë.

Një rast i ngjashëm ka ndodhur përsëri në vitin 2021. OSHP aprovoi pjesërisht ankesën e OE i cili ishte futur në Listë të Zezë në të njëjtën ditë që është aprovuar ankesa e tij dhe ku tenderi ka qenë i njëjtë. Kompania 2-Tech SH.P.K është futur në listë të zezë më 22 janar 2021 për arsye se ka [falsifikuar](#) vërtetimin e ATK-së se nuk është në borxhe për tenderin “Mirëmbajtja e pikave të Antena” të publikuar nga AK – Policia e Kosovës²⁷. Pikërisht për të njëjtin tender, kompania 2-Tech ka bërë ankesë në OSHP, e cila të njëjtën ditë, më 22 janar 2021 ka aprovuar pjesërisht ankesën, mirëpo ka lënë në fuqi vendimin e AK për dhënie të kontratës. Edhe ky rast dëmton reputacionin e OSHP-së që [aprovoi ankesën](#)²⁸ e kompanisë të futur në Listë të Zezë. Për më tepër, ankesa është aprovuar pjesërisht edhe pse në vendim thuhet që ATK ka cilësuar që vërtetimi tatimor është falsifikuar. Në vendim nuk ka ndonjë pikë tjetër për të cilën ka mundur të aprovohet ankesa pjesërisht. Kjo ka mundur të ndodhë për shkak se edhe eksperti shqyrtues i këtij rasti ka [rekomanduar](#) që ankesa të aprovohet pjesërisht, edhe pse edhe në ekspertizë nuk ka ndonjë pretendim që është aprovuar. Zinxhiri i papërgjegjësive përfundon me zyrtarët ligjor, të cilët shkruajnë vendimet, të cilët siç duket nuk kanë pasur parasysh që kompania është futur në Listë të Zezë. Ankesa e 2-Tech është dashur të refuzohet me arsyen se kompania është futur në Listë të Zezë. Për më tepër, ankesa është dashur të refuzohet vetëm se ATK ka konstatuar që vërtetimi tatimor është falsifikuar.

OSHP “ngatërron” kompanitë në Listë të Zezë

Emri i përafërt i dy kompanive, Lirigzoni SH.P.K dhe Lirigzoni S SH.P.K., ka bërë që OSHP të fus në listë të zezë kompaninë e gabuar. OSHP më [19 nëntor 2019 vendosi](#)²⁹ në Listë të Zezë kompaninë Lirigzoni me arsyen se ka falsifikuar një dokument. Mirëpo në vendimin [728/19](#)³⁰, OSHP e hodhi poshtë ankesën si të palejuar të kompanisë Lirigzoni S SH.P.K me arsyen se është diskualifikuar përmes vendimit 1148/19 të publikuar më 19 nëntor 2019. Në fakt përmes këtij vendimi ishte diskualifikuar kompania Lirigzoni SH.P.K. Këtu nuk ka të bëjë me ndonjë gabim teknik, pasi në ankesën 728/19 shkruan qartazi që ankues është Lirigzoni S SH.P.K, në pjesën hyrëse të vendimit 728/19 shkruan që ankues është Lirigzoni S SH.P.K, në vendimin për futje në Listë të Zezë të kompanisë Lirigzoni SH.P.K janë të shënuar numri unik identifikues, numri i biznesit dhe numri fiskal. Pra OSHP e ka ditur se për cilën kompani

²⁶ Organi Shqyrtues i Prokurimit. Vendimi 728/19. 2019
<https://oshp.rks-gov.net/sq/ProcurementActivities/Download/dfb0bbf2-8d25-ea11-b589-005056ba09d5>

²⁷ Organi Shqyrtues i Prokurimit. Vendimi 973/20. 2021
<https://oshp.rks-gov.net/sq/Documents/Download?id=5b9ff99d-1a5f-eb11-b595-005056ba09d5>

²⁸ Organi Shqyrtues i Prokurimit. Vendimi 10/21. 2021.
<https://oshp.rks-gov.net/sq/ProcurementActivities/Download/796ae902-af5f-eb11-b595-005056ba09d5>

²⁹ Organi Shqyrtues i Prokurimit. Vendimi 1148/19. 2019
<https://oshp.rks-gov.net/sq/Documents/Download?id=6a4b1d3c-0c20-ea11-b589-005056ba09d5>

³⁰ Organi Shqyrtues i Prokurimit. Vendimi 728/29. 2019.
<https://oshp.rks-gov.net/sq/ProcurementActivities/Download/dfb0bbf2-8d25-ea11-b589-005056ba09d5>

bëhet fjalë, mirëpo si pasojë e neglizhencës dhe joprofesionalizmit ka refuzuar ankesën e kompanisë që nuk ka qenë në Listë të Zezë.

Gabimet e ekspertëve shqyrtues / caktimi i ekspertëve jokompetent

Eksperti shqyrtues, në ankesën [1095/20](#) të OE D&T Group, gabimisht ka cilësuar ndryshimin e normës së TVSH-së si gabim aritmetikor. Sipas interpretimit të KRPP, nëse norma e TVSH-së është gabim, atëherë ajo përmirësohet nga autoriteti kontraktues dhe nuk cilësohet si gabim aritmetikor. Sipas LPP nëse oferta përmban gabime aritmetike në nivelin mbi 2% atëherë oferta duhet të refuzohet. OE ka dhënë çmimin me 18% TVSH, ndërsa sipas autoritetit kontraktues, TVSH është dashur të jetë 8%. Pikërisht për këtë arsye, eksperti shqyrtues e cilësoi që oferta e D&T Group ka gabime aritmetike. D+ edhe në të kaluarën [ka gjetur](#)³¹ se i njëjti ekspert ka bërë gabime të rënda, por siç duket asnjë masë nuk është marrë ndaj tij. Fatmirësisht rekomandimin e tij nuk e mori parasysh paneli shqyrtues, i cili për këtë pikë citoi interpretimin nga KRPP se dallimet në TVSH nuk cilësohen gabime aritmetike.

Në një rast tjetër OSHP ka caktuar një ekspert të teknologjisë informative për të shqyrtuar një ankesë në të cilën kishte vetëm pretendime të procedurave të prokurimit. Më saktë, autoriteti kontraktues Telekom i Kosovës, me të drejtë kishte eliminuar konsorciumin Fahredin Pllana B.I & NTSH Stina shpk me arsyen se anëtari NTSH Stina nuk ka dorëzuar deklaratën nën betim. Pretendimi i OE Fahredin Pllan B.I si lideri i konsorciumit ishte se pasi ai ka dorëzuar një deklaratë nën betim të nënshkruar në emër të konsorciumit, ajo duhet të vlejë për të dy anëtarët. Eksperti i këtij rasti e aprovoi në tërësi këtë pretendim dhe [rekomandoi](#) që ankesa të aprovohej dhe të kërkohen sqarime për deklaratën nën betim. Në këtë rast kërkesa për sqarim, nënkupton që OE të lejohet të dorëzojë një deklaratë të re nën betim. Mirëpo neni 65 i LPP dhe neni 39.8 i RRUOPP kërkojnë që deklarata nën betim të dorëzohet nga të gjithë anëtarët e konsorciumit, pasi nuk mundet lideri i grupit të garantojë, p.sh se anëtari tjetër nuk është i dënuar për ndonjë vepër penale. Shqetësues mbetet fakti se si OSHP ka caktuar një ekspert jo adekuat për të trajtuar ankesën. Edhe në këtë rast paneli shqyrtues [nuk e mori parasysh](#) rekomandimin e ekspertit dhe vendosi që ky pretendim ankimor të refuzohet, pasi me të drejtë AK e ka eliminuar konsorciumin për mosdorëzim të deklaratës nën betim nga NTSH Stina.

Në një rast tjetër, eksperti shqyrtues ngatërroi një interpretim nga KRPP dhe dha rekomandim të gabuar. Në tenderin për ndërtimin e Shtëpisë së Kulturës – Ukë Bytyqi – faza e dytë, përveç të tjerëve ofertoj kompania ISeferi SH.P.K., ndërsa OE i rekomanduar për kontratë, Euroing SH.P.K kishte marrë disa pajisje me qera nga ISeferi. Për këtë pikë u ankua Ada Consulting Group SH.P.K & Krapit Com të cilat pretenduan që ISeferi ka ofertuar si e vetme dhe me një grup të operatorëve ekonomik. Ofertimi i tillë do t'i bënte të dy ofertat e papërgjegjshme sipas nenit 71 të LPP. Mirëpo në këtë rast një gjë e tillë nuk ka ndodhur, pasi ISeferi ka ofertuar e vetme dhe disa pajisje të saj i ka dhënë në shfrytëzim. Vetëm pajisjet nuk e përbëjnë ofertën, që në këtë rast vlera e tij ka qenë 2.6 milionë euro. Eksperti shqyrtues rekomandimin e tij e mbështeti në interpretimin nga KRPP, Pyetjet e Shpeshta nr. 48. Mirëpo ai gabimisht e interpretoi këtë dispozitë. Interpretimi flet vetëm për rastet kur një OE nuk ka të drejtë të ofertojë si e vetme dhe si një anëtar i një konsorciumi. Kjo gjë pothuajse asnjëherë nuk ndodh, pasi OE e dëjton që do të cilësohen të papërgjegjshëm nëse ofertojnë në mënyrë të tillë. Megjithatë, eksperti shqyrtues e cilësoi pretendimin e dy

³¹ Demokraci Plus. Roli i OSHP-së në mosefikasitetin në prokurim publik. Faqe 38. 2019
<https://dpl.us/x38>

ankuesve si të bazuar. Paneli shqyrtues, në vend që të përmirësojë rekomandimin e gabuar të ekspertit, vendosi në përputhje me ekspertizën. Edhe pse në këto dy ankesa ka edhe pretendime tjera, aprovimi i këtij pretendimi nga paneli shqyrtues është precedent i gabuar. Me një rekomandim të gabuar nga eksperti, paneli shqyrtues i cilësoi si të papërgjegjshme ofertën e ISeferi dhe të Euroing (e cila ka marrë pajisjet me qera nga ISeferi) pasi sipas panelit, ISeferi me rastin e lidhjes së marrëveshjes me OE të rekomanduar është bërë pjesë e ofertës së tij. Me këtë arsyetim paneli e ka cilësuar se ISeferi ka ofertuar si e vetëm dhe së bashku me Euroing.

Mirëpo, siç ka ndodhur zakonisht në të kaluarën, gabimi në vendimmarrje sjell vendime jokonsistente mes vete. Disa muaj më vonë, OE Gurëbardhi, në [ankesën](#) e tij përmendi vendimin 984/20, e ku pretendimi ishte i njëjtë. Përsëri kompania ISeferi kishte ofertuar si e vetme dhe pajisjet e saj ja kishte dhënë me qera OE të rekomanduar për kontratë. Eksperti shqyrtues, e [konstatoi](#) këtë gjë dhe tha që për këtë pretendim vlen vendimi 984/20. Megjithatë paneli shqyrtues [nuk u pajtua](#) me rekomandimin e ekspertit dhe u arsyetua se ISeferi ka ofertuar si i vetëm dhe që pajisjet i ka dhënë vetëm në shfrytëzim. Sipas panelit këtu kemi të bëjmë me dy oferta të ndryshme. Në fakt ky do të duhej të ishte edhe arsyetimi në vendimin 984/20. Mirëpo paneli shqyrtues, për të arsyetuar gabimin e tij, arsyetimin e bazoi në interpretimin nga KRPP, Pyetjet e Shpeshta nr. 12, i cili thotë se ofertuesi e konfirmon se nuk është duke marrë pjesë në tender me ndonjë grup tjetër. Ky interpretim është aq i vjetër³², sa në atë kohë OSHP nuk ka qenë e themeluar dhe në fuqi ka qenë një ligj tjetër për prokurim publik. Ka mjaftuar që për këtë pikë, paneli shqyrtues të bazohet në nenin 71 të LPP ose në interpretimin nr. 44 të KRPP-së.

³² Interpretimi është publikuar në vitin 2011.

Rekomandime:

Duke u bazuar në gjetjet e këtij raporti, dhe monitorimin e vazhdueshëm të OSHP-së, D+ propozon këto rekomandime për të përmirësuar vendimmarrjen nga OSHP:

- OSHP të mos aprovojë pjesërisht ankesat vetëm për të mos konfiskuar tarifën e ankesës. OSHP do të duhej që të konfiskojë më shpesh tarifën;
- OSHP të krijojë një databazë të avancuar të vendimeve të saj në mënyrë që ta ketë më të lehtë gjetjen e vendimeve për një çështje të caktuar në mënyrë që të sigurohet konsistencë në vendimmarrje. OSHP do të duhej që për një çështje të caktuar të vendosë gjithmonë njëjtë apo kur kjo është e papërshtatshme të arsyetoj devijimin nga precedentët paraprak;
- OSHP të bëjë matjen e performancës dhe cilësisë së punës së ekspertëve për të siguruar profesionalizëm dhe paanshmëri, e sidomos kur ndaj tyre ka pretendime se nuk e kanë kryer punën si duhet. Do të duhej urgjentisht që të ketë një auditim të rekomandimeve të tyre. Këtë OSHP do të duhej ta bënte duke kontraktuar ndonjë palë të tretë.
- T'i bëhet matje e cilësisë secilit ekspert duke përcjellur suksesin e rekomandimeve të tij/saj, afatin e trajtimit të lëndëve dhe indikatorë të tjerë, për të përcaktuar nëse duhet të mbahet si i tillë në OSHP apo të zëvendësohet me të tjerë;
- OSHP të trajtojë me kujdes të veçantë pretendimet për tenderë jonormalisht të ulët dhe të marr qëndrim të njëjtë;
- OSHP të hartojë një listë të pretendimeve më të zakonshme nga OE dhe publikojë në uebfaqen e saj mënyrën se si do të vendosë për këto pretendime. Në këtë mënyrë OE do ta dijnë paraprakisht se a do të aprovohet pretendimi i tyre. Kjo do të zvogëlonte numrin e ankesave të dorëzuara;
- OSHP t'i kushtojë vëmendje më të madhe zbatimit të vendimeve të saj, duke krijuar mekanizma monitorues të zbatimit të vendimeve dhe të aplikojë masa ndëshkuese për AK të cilat nuk i zbatojnë vendimet apo të cilat shkelin afatet;
- Të bëhet publikimi i të gjitha vendimeve, ankesave, raporteve të ekspertëve si dhe dokumenteve tjera që janë me rëndësi në një format të lexueshëm elektronikisht;
- OSHP të mos aprovojë ankesat e kompanive të cilat janë vërtetuar nga vendimet e mëparshme të OSHP-së që kanë të dënuar për vepër penale personat drejtues sipas përkufizimit të nenit 65 të LPP.
- Paneli shqyrtues të japë arsyetim në vendim kur nuk pajtohet me rekomandimin e ekspertëve. Përderisa kur paneli pajtohet me ekspertin fjalía fillon "Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues...", atëherë edhe paneli duhet të japë arsyetim kur nuk pajtohet me ekspertin shqyrtues.



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

